

**Rregullore për  
Procedurën e  
Regjistrimit në Tregun e Energjisë  
Elektrike**

**Kapitulli  
I  
Të  
Përgjithshme**

NENI 1

Këto dispozita, hartohen në zbatim të Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, Kapitulli III, pika *III.1.2*, të miratuara me Vendimin nr. 139, datë 15.08.2016 të Bordit të ERE, ndryshuar.

NENI 2

Kjo rregullore, përcakton procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike për çdo person, fizik apo juridik, vendas apo i huaj, të pajisur me Licencë nga Enti Rregullator i Energjisë në përputhje me nenin 37 të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i cili kërkon të marrë pjesë në Tregun e Energjisë Elektrike të organizuar nga Operatori Tregut të OST sh.a.

**Kapitulli  
II  
Aplikimi**

NENI 3

Aplikuesi që kërkon të regjistrohet për pjesëmarrje në tregun shqiptar të energjisë elektrike plotëson formularin A1 bashkëlidhur të miratuar nga OST sh.a. Ky formular tërhiqet pranë OST - OT ose në internet në faqen elektronike të OST sh.a.

NENI 4

Formulari dhe dokumentacioni bashkëngjitur, dërgohen me postë pranë OST-OT, shoqëruar me një kërkesë zyrtare .

NENI 5

Aplikuesi do t'i bashkëngjisë formularit A1 të regjistrimit dokumentet e mëposhtme:


- Informacion teknik, të miratuar nga OST sh.a.;
  - Licenca, kopje e noterizuar;
  - Dokumente të lëshuar nga OST sh.a. dhe/ose OSSH që jep akses në Rrejt atë të
-

Transmetimit dhe/ose Shpërndarjes për rastet e Tranzitimeve;

- Një kopje të certifikuar të bilancit të fundit vjetor dhe të depozituar në organet e tatimtaksave;
- Përshkrim për mjetet e komunikimit, deklaratë origjinale e aplikuesit;
- Informacion mbi detajet dhe mënyrën e komunikimit.

#### NENI 6

Çdo aplikues/ palë e licencuar që dëshiron të bëhet pjesëmarrëse në tregun shqiptar të energjisë elektrike duhet të depozitojë në OST-OT garancinë financiare për të gjitha



shërbimet që sigurohen nga OST sh.a., në përputhje me "Procedurat për llogaritjen e garancisë dhe kontrollin e depozitave" të përgatitura nga OST-OT dhe të miratuara nga ERE.

#### NENI 7

Brenda 10 ditëve punë nga marrja e dokumenteve të regjistrimit, OST-OT do të verifikojë të dhënat e aplikimit dhe dokumentet bashkëngjitur. Jo më vonë se 3 ditë punë pas përfundimit të këtoj afati do ti dërgojë njoftim aplikuesit për vendimin e marrë lidhur me aplikimin për regjistrim në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me Formularin A2 të miratuar nga OST sh.a..

### **Kapitulli III**

#### **Pranimi i**

#### **Aplikimit**

#### NENI 8

Aplikuesi që ka marrë njoftimin për pranimin e aplikimit për regjistrim në tregun e energjisë elektrike ose i janë rekomanduar udhëzime dhe kushte të detyrueshme për rregullimin e gabimeve të mundshme në formularët e aplikimit dhe dokumentet bashkëngjitur duhet të kthejë përgjigje për plotësimin e kërkesave të parashtruara në këtë formular, nga OST-OT, brenda 10 ditëve punë, nga dita që ka marrë njoftimin.

#### NENI 9

Pas zbatimit të gjithë kërkesave të mësipërme të regjistrimit, OST-OT do të regjistrojë pjesëmarrësin në regjistrin e palëve dhe do të nënshkruajë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në Treg, të miratuar nga ERE.

#### NENI 10

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Treg nga përfaqësuesi i autorizuar i aplikuesit, regjistrimi si pjesëmarrës i ri i tregut bëhet efektiv në datën e zbatimit të saj.

#### NENI 11

OST-OT do të publikojë në faqen e saj të internetit një listë të palëve të regjistruara me informacion mbi emrin, numrin e identifikimit, datën e regjistrimit dhe statusin.

#### NENI 12

Çdo palë është e detyruar t'i dërgojë informacion operatorit të tregut mbi ndryshimin e informacionit të dhënë në regjistrim, brenda 6 ditëve punë nga ndodhja e ndryshimit.

#### NENI 13


OST-OT do t'i regjistrojë zyrtarisht të gjithë pjesëmarrësit e tregut në tregun e energjisë elektrike duke i evidentuar në një regjistër të veçantë.

---

**Kapitulli**  
**IV**  
**Refuzimi i Aplikimit dhe Mosmarrëveshja për**  
**Regjistrimin**

NENI 14

OST-OT mund ta refuzojë regjistrimin në tregun e energjisë elektrike nëse konstaton këto raste:



- a) Gabime në formularin e regjistrimit dhe dokumentet bashkangjitur që nuk janë korigjuar brenda 10 ditëve punë pavarësisht njoftimit për kosntatimin e këtyre të metave.;
- b) Detyrime ndaj Operatorit të Rrjetit të Transmetimit të OST sh.a., që nuk janë likuiduar.

OST-OT nuk do ta regjistrojë një palë në rast mosplotësimi të kushteve brenda termave të përcaktuara në këtë rregullore dhe në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjise Elektrike.

#### Neni 15

Në rast refuzimi të regjistrimit, aplikuesi ka të drejtë ta kundërshtojë refuzimin me një /ankesë drejtuar ERE brenda 10 ditëve pune pas marrjes së tij.

#### Neni 16

ERE do të verifikojë nëse arsyet e refuzimit janë të justifikuar dhe do të marrë vendimin brenda 15 ditëve punë nga marrja e tij.

#### Neni 17

Në rast refuzimi të regjistrimit nga OST-OT, aplikuesi mund të nisë një procedurë të re regjistrimi në tregun e energjisë elektrike, 1 muaj pas datës kur refuzimi i OST-OT merr formë të prerë.

Refuzimi i regjistrimit të dhënë nga OST-OT merr formë të prerë të nesërmen e marrjes dijeni për vendimin e ERE-s që le në fuqi këtë refuzim.

Në të kundërt, refuzimi i regjistrimit merr formë të prerë pas mbarimit të afatit të ankimit në ERE, prej 10 ditë pune.

#### Neni 18

Në rast se vendimi i ERE-s konfirmon se Operatori i Tregut e ka refuzuar në mënyrë të pajustificuar regjistrimin në tregun e energjisë elektrike, OST-OT është e detyruar që brenda 5 ditëve punë nga marrja e vendimit të ERE-s t'i dërgojë aplikuesit një njoftim për pranimin e formularit të regjistrimit në tregun e energjisë elektrike.

### **Kapitulli V**

### **Kërkesa për Terheqje, Pezullimi dhe Përfundimi i Pjesëmarrjes në Treg**

#### Neni 19

Një pjesëmarrës tregu mund të tërhiqet nga tregu i energjisë elektrike me iniciativën e tij, bazuar në një njoftim me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i këtij pjesëmarrësi, në përputhje me Formularin A3 të miratuar nga OST sh.a.. Njoftimi duhet paraqitur të paktën 3 muaj para datës së anulimit të regjistrimit të pjesëmarrësit të tregut. Pas marrjes së këtij njoftimi, OST-OT do të informojë menjëherë të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

#### Neni 20

Nëse pjesëmarrësi nuk mund t'i plotësojë të gjitha kushtet e Rregullave të Tregut atëherë pjesëmarrësi ose OST-OT duhet të informojnë ERE-n brenda 10 ditë pune.

#### Neni 21

1- OST -OT do të pezullojë marrëveshjen për pjesëmarrjen në treg të

---

pjesëmarrësit, nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

- a) Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më një ose më shumë kushte të nevojshme për regjistrim si pjesëmarrës tregu (siç përcaktohet në këto Dispozita).
-

- b) Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më kërkesat që lidhen me garancinë financiare ose nuk bën pagesat e tjera (të parashikuara në këto Dispozita).

#### Neni 22

Nëse pjesëmarrësi i tregut nuk mund të provojë se e ka shmangur shkakun (Shkaqet) që shkaktoi pezullimin e tij, gjatë periudhës së specifikuar në njoftimin për pezullim, atëherë OST-OT do të procedojë me përfundimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Treg.

Nëse ky vendim i OST-OT kundërshtohet nga pjesëmarrësi atëherë pas paraqitjes së ankesës, ERE do të verifikojë nëse arsyet për pezullimin e veprimtarive tregtare janë të justifikuara dhe do të marrë vendimin brenda 15 ditëve punë nga marrja e ankesës.

#### Neni 23

Nëse regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut pezullohet atëherë të gjitha ofertat e mbetura pezull (të reja) të pjesëmarrësit të tregut do të anulohen automatikisht për gjithë periudhën e pezullimit.

#### Neni 24

OST-OT ka të drejtë të përfundojë Marrëveshjen për Pjesëmarrje në Treg të një pjesëmarrësi tregu, në secilin nga këto raste:

- Nëse pjesëmarrësi i tregut nuk respekton Marrëveshjen për Pjesëmarrjen në Treg.
- Nëse pjesëmarrësi në mënyrë të përsëritur shkel rregullat e tregut dhe kodeve në fuqi për tregun shqiptar të energjisë elektrike.

#### Neni 25

OST-OT shfuqizon menjëherë Marrëveshjen për Pjesëmarrjen në Treg, kur ERE i heq pjesëmarrësit në treg licencën përkatëse. Të gjithë ofertat e tregut të këtij pjesëmarrësi anulohen automatikisht që nga data e deklaruar në njoftim.

#### Neni 26

Pjesëmarrësi i tregut, Marrëveshja për Pjesëmarrjen në Tregun e të cilit ka përfunduar, është përgjegjës për gjithë detyrimet ligjore që ka ndaj OST-OT.

#### Neni 27

Këto dispozita hyjnë në fuqi pas miratimit nga ERE.

---

X

Logo e Aplikuesit

## FORMULARI A 1

### Aplikim për Pjesëmarrje në Tregun e Energjisë Elektrike

Nr \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_

- Aplikuesi: \_\_\_\_\_
- Adresa: \_\_\_\_\_
- Tel: \_\_\_\_\_, fax: \_\_\_\_\_, e-mail \_\_\_\_\_
- Numri Identifikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit: NUIS \_\_\_\_\_
- Licensuar nga ERE me Vendim Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_
- Me llogari në Bankën \_\_\_\_\_  
Nr. Llogarie \_\_\_\_\_, kod \_\_\_\_\_
- Energjia elektrike e përdorur / gjeneruar në një vit, para datës së aplikimit është \_\_\_\_\_ MËh

- Bashkëlidhur edhe dokumentacioni vijues :

1. Licenca (për aktivitetin e licencuar - dokument kopje e noterizuar)
2. Informacion teknik (Formular TIP i miratuar nga OST –dokument origjinal)
3. Dokument të lëshuar nga OST dhe/ose OSSH që jep akses në rrjet (nëse disponohet, për rastet e tranziteve në rrjetin e Transmetimit dhe/ose Shperndarjes – dokument kopje)
4. Bilanci vjetor, i depozituar në organet e tatim taksave (për vitin e fundit kalendarik – dokument kopje noterizuar)
5. Përshkrim për mjetet e komunikimit (Formular TIP i miratuar nga OST – dokument origjinal)
6. Informacion mbi detajet dhe mënyren e komunikimit (Formular TIP i miratuar nga OST – dokument origjinal)
7. Garancia Financiare e Regjistrimit në Treg (lëshuar nga Banka, mbështetur në Formular TIP i miratuar nga OST - dokument origjinal)

Subjekti i Licencuar: \_\_\_\_\_

Administratori  
(nenshkrimi dhe vula)

X

Logo e OST

## FORMULARI A 2

Nr. \_\_\_\_\_ Prot, datë \_\_\_\_\_

### Njoftim mbi Aplikimin për Pjesëmarrje në Tregun e Energjisë Elektrike

Drejtuar:

- Aplikuesit: \_\_\_\_\_

- Adresa: \_\_\_\_\_

- Tel: \_\_\_\_\_, fax: \_\_\_\_\_, e-mail \_\_\_\_\_

- Numri Identifikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit: NUIS \_\_\_\_\_

Në përgjigje të aplikimit tuaj, Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ për regjistrim në tregun shqiptar të energjisë elektrike dhe në zbatim të "Rregullore për Procedurën e Regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike", ju njoftojme:

A. Aplikimi juaj për regjistrim pranohet, pasi është i plotë dhe i rregullt.

B. Aplikimi juaj refuzohet, pasi nuk është i plotë dhe/ose i rregullt:

a. \_\_\_\_\_

b. \_\_\_\_\_

c.

Plotësimi dhe/ose korrektimi i aplikimit duhet bërë brenda 10 dite punë nga data e marjes së këtij njoftimi.

Operatori i Tregut

Shënim: Ky njoftim plotësohet vetëm në nje version: A ose B

# X

Logo e Subjektit Licencuar

## Informacion

### Mbi detajet dhe mënyrën e komunikimit në tregun e energjisë elektrike

Të dhëna të subjektit të licencuar

Emri i subjektit të Licencuar: \_\_\_\_\_ Sipas specifikimit në Licencë  
Adresa: \_\_\_\_\_ Adresa e rezidencës kryesore të Licencuarit  
Numri Identifikimit në QKB: NUIS \_\_\_\_\_  
Tel. \_\_\_\_\_ Fax. \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_

Pas regjistrimit në Tregun Shqiptar të Energjisë Elektrike, për kryerjen e aktivitetit të licencuar:

- Autorizoj, për dërgimin dhe konfirmimin e dokumentave që lidhen me punën operative në tregun e energjisë elektrike, personin/ personat:

1. \_\_\_\_\_ Tel. \_\_\_\_\_ Fax. \_\_\_\_\_ e-mail \_\_\_\_\_  
2. \_\_\_\_\_ Tel. \_\_\_\_\_ Fax. \_\_\_\_\_ e-mail \_\_\_\_\_  
3.

- Autorizoj, për nënshkrimin e kontratave dhe faturave, që lidhen me aktivitetin në tregun e energjisë elektrike, personin/ personat:

1. \_\_\_\_\_ Tel. \_\_\_\_\_ Fax. \_\_\_\_\_ e-mail \_\_\_\_\_  
2. \_\_\_\_\_ Tel. \_\_\_\_\_ Fax. \_\_\_\_\_ e-mail \_\_\_\_\_  
3.

Subjekti i Licencuar: \_\_\_\_\_

Administratori  
(nënshkrimi dhe vula)



Logo e Subjektit Licencuar

## Informacion Teknik Furnizues

Tw dhwna tw subjektit tw licencuar pwr Furnizim tw Energjisw Elektrike

<b>Emertimi</b>	<b>Specifikimi</b>	<b>Shenime</b>
Emri i subjektit Licencuar		Sipas specifikimit nw Licencw
Rezidenca		Adresa e rezidencws kryesore tw Licencuarit
Licenca	Nr ___ datw _____	Sipas specifikimit nw Licencw
Afati Licences		Sipas pwrcaktimit nw Licencw
Aktiviteti i Licencuar		Sipas pwrcaktimit nw Licencw
Autoriteti Licencues		Emri, shteti rezident i autoritetit licencues
Kodi EIC		
Te dhwna Financiare	Banka, adresa, llogaria bankare, kodi bankar	
Volumi transaksioneve	_____ MWh	Volumi ne vitin e fundit kalendarik

Subjekti i Licencuar: \_\_\_\_\_

Administratori  
(nenshkrimi dhe vula)



Logo e Subjektit Licencuar

## Informacion Teknik Prodhuesit e Energjisë Elektrike

Të dhëna për subjektin e licencuar për Prodhimin e Energjisë Elektrike

Emërtimi	Specifikimi	Shënime
Emri Centralit		Sipas Licencës ose sipas projektit
Pronësia	Publik ose Privat ose Koncesion	
Kapaciteti Total i Centralit	_____MË	
Numri i njësive gjeneruese	_____njësi	
Kapaciteti njësive gjeneruese	_____MË	
Lënda e parë	Qymyr ose gaz ose ujë ose PV, etj	
Tipi centralit	Kogjenerim, run of river, rrezatim diellor, etj	
Efienca e prodhimit	Kg /këh ose m <sup>3</sup> /këh, ose m <sup>2</sup> /kë, etj	Në vitin e fundit kalendrik ose sipas projektit
Prodhimi mesatar vjetor	Këh/ vit	Në vitin e fundit kalendrik ose sipas projektit
Viti i vënies në shfrytezim		Viti i vënies në shfrytezim i njësisë së pare
Pika e lidhjes	OST ose OSHEE, etj	Emri i kompanisë që administron rrjetin
Tensioni në pikën e lidhjes	220 KV ose 110 KV ose 35 KV, etj	Tensioni i rrjetit në pikën e lidhjes
Pika/ Pikat e Matjes	Psh ana 6 kv e Tr T1, etj	Specifikime mbi pikën ose pikat e matjes
Kodi pikës/ pikave të Matjes		Sipas Sistemit Menaxhimit Matjes të op. rrjetit

Subjekti i Licencuar: \_\_\_\_\_

Administratori  
(nenshkrimi dhe vula)

Shenim: Ky Formular plotësohet veçmas për çdo central të përfshirë në Licencën e të Licencuarit

\_\_\_\_\_

**Informacion Teknik**  
**Operim i Sistemit të Shpërndarjes**

Të dhëna të subjektit të licencuar për Shpërndarje të Energjisë Elektrike

<b>Emertimi</b>	<b>Specifikimi</b>	<b>Shenime</b>
Emri i subjektit Licencuar		Sipas specifikimit në Licencë
Rezidenca		Adresa e rezidencës kryesore të Licencuarit
Licenca	Nr ___ datë _____	Sipas specifikimit në licencë
Afati Licencës		Sipas pëcaktimit në Licencë
Aktiviteti i Licencuar		Sipas përcaktimit në Licencë
Kodi EIC		
Te dhëna Financiare	Banka, adresa, llogaria bankare, kodi bankar	
Zona operimit shpërndarjes	Kufijte gjeografike të zonës	Sipas specifikimit në Licencë
Pika/ pikat e lidhjes me ST		Linja/ linjat dhe/ ose zbara/ zbarat lidhëse me OST
Kodi i pikes/ pikave të Matjes me ST		Sipas Sistemit Menaxhimit të Matjes i OST
Pika/ pikat e lidhjes me SSh		Linja/ linjat dhe/ ose zbara/ zbarat lidhëse me Operatorin Publik të Shpërndarjes
Kodi i pikës/ pikave të matjes me SSh		Sipas Sistemit të Menaxhimit të Matjes i Operatorit Publik të Shpërndarjes
Të dhëna mbi zonën e shpërndarjes	Prodhimi zonës (MWh/ vit), konsumi zonës (MWh/ vit), nr. konsumatoreve tarifore dhe nr. i konsumatorëve jo-tarifore.	Sipas vlerësimeve të paraqitura nga i licencuari në aplikimin për Licencë

Subjekti i Licencuar: \_\_\_\_\_

Administratori  
(nënshkrimi dhe vula)

---

# X

Logo e Subjektit Licencuar

## Informacion Teknik Tregtuesi

Të dhëna të subjektit të licencuar

Emertimi	Specifikimi	Shenime
Emri i subjektit Licencuar		Sipas specifikimit në Licencë
Rezidenca		Adresa e rezidencës kryesore të Licencuarit
Licenca	nr____datë _____	Sipas specifikimit në Licencë
Afati Licencës		Sipas përcaktimit në Licencë
Aktiviteti i Licencuar		Sipas përcaktimit në Licencë
Autoriteti Licencues		Emri, shteti rezident i autoritetit licencues
Kodi EIC		
Të dhëna Financiare	Banka, adresa, llogaria bankare, kodi bankar	
Volumi transaksioneve	_____MWh	Volumi ne vitin e fundit kalendarik

Subjekti i Licencuar:

\_\_\_\_\_

Administratori  
(nënshkrimi dhe vula)

\_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

datë \_\_\_\_\_

Drejtuar: z. \_\_\_\_\_

**Administratori i OST sha**

**Lënda: Kërkesë për regjistrim në Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike**

**I nderuar z. \_\_\_\_\_,**

Në zbatim të "Rregullave të Tregut", miratuar nga ERE me Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_, ju drejtohem me kërkesën për regjistrim, për tu bërë Palë në Tregun Shqiptar të Energjisë Elektrike, në përputhje me procedurën përkatëse të miratuar nga ERE.

Bashkëlidhur do të gjeni të plotësuar aplikimin për regjistrim si edhe dokumentacionin e nevojshëm shoqërues.

Për të ndjekur procedurën e regjistrimit në Operatorin e Tregut:

Autorizoj z. \_\_\_\_\_,

Adresa: \_\_\_\_\_,

Tel: \_\_\_\_\_, Fax: \_\_\_\_\_, e-mail: \_\_\_\_\_

Subjekti i Licencuar: \_\_\_\_\_

Administratori  
(nënshkrimi dhe vula)

# X

Logo e Subjektit Licencuar

## Përshkrim

### Mbi Mjetet e komunikimit në tregun e energjisë elektrike

Emri i subjektit \_\_\_\_\_ *Sipas specifikimit në Licencë*

Licencuar: Adresa: \_\_\_\_\_ *Adresa e rezidencës kryesore të Licencuarit*

Numri Identifikimit në *NUIS* \_\_\_\_\_

QKB:

Tel. \_\_\_\_\_ Fax. \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_

Për kryerjen e aktivitetit të licencuar në tregun shqiptar të energjisë elektrike, do të komuikohet me Operatorin e Tregut, në përputhje me procedurat përkatëse të komunikimit, përcaktuar në "Rregullat e Tregut" dhe akteve të tjera që rregullojnë Tregun Shqiptar të Energjisë Elektrike, nëpërmjet:

- nëpërmjet komunikimit elektronik, adresat e të cilave janë deklaruar në "Informacionin mbi detajet e komunikimit"
- nëpërmjet Fax, në numrin \_\_\_\_\_ përkatës të deklaruar në "Informacionin mbi detajet e komunikimit"
- nëpërmjet numrit të telefonit dhe personave përkatës të autorizuar, të cilat janë deklaruar në "Informacionin mbi detajet e komunikimit"
- nëpërmjet shërbimit të postës, në adresën e deklaruar në "Informacionin mbi detajet e komunikimit"

Për cdo ndryshim të të dhënave të deklaruara për komunikimin, që lidhen me operimin në tregun e energjisë elektrike, Operatori i Tregut do të njoftohet nëpërmjet ndryshimit të deklarimeve në "Informacionin mbi detajet e komunikimit", në afatet e përcaktuara në "Rregullat e Tregut".

Operatori i Tregut do të njoftojë tek personat e autorizuar në "Informacionin mbi detajet e komunikimit", pas nënshkrimit të "Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Treg", adresat dhe kodet e nevojshme të komunikimit për kryerjen e transaksioneve në treg.

Subjekti i Licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori  
(nenshkrimi dhe vula)*

X

Logo e Aplikuesit

## FORMULARI A3

### Kërkesë për Tërheqje nga Tregu i Energjisë Elektrike

Nr. \_\_\_\_\_ date \_\_\_\_\_

- Aplikuesi: \_\_\_\_\_

- Adresa: \_\_\_\_\_

- Tel : \_\_\_\_\_, fax \_\_\_\_\_, e-maili  
\_\_\_\_\_

- Numri Identifikimit në Qendrën Kombetare të Biznesit: NUIS \_\_\_\_\_

- Licensuar nga ERE me Vendim Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_

Në zbatim të "Rregullave të Tregut", miratuar nga ERE me Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_, ju drejtohem me kërkesën për tërheqje nga Tregu i Energjisë Elektrike, në përputhje me procedurën përkatëse të miratuar nga ERE.

Për të vepruar në emrin tim, për të ndjekur procedurën e çregjistrimit në Operatorin e Tregut: Autorizoj z. \_\_\_\_\_,

Adresa: \_\_\_\_\_,

Tel: \_\_\_\_\_, Fax: \_\_\_\_\_, e-mail: \_\_\_\_\_

Subjekti i Licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori  
(nënshkrimi dhe vula)*